



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.13.1-2012-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË RAHOVECIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2012

Prishtinë, Qershor 2013

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 140 anëtarë të stafit. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe që certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP në mënyrë direkte promovojnë llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti mbajtur llogaridhënës menaxherët e organizatave individuale buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Rahovecit në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili ka bërë mbikëqyrjen e auditimit.

Opinionin dhe raportin i nxjerrë janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri mbështetur nga Lavdim Maxhuni (Udhëheqës i ekipit), Faik Thaqi, Evetar Zeqiri dhe Shpresa Zenelaj.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	6
2 Pasqyrat vjetore financiare.....	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak	10
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	11
5 Sistemi i auditimit të brendshëm	24
6 Konkluzioni i përgjithshëm	25
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZAP	26
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	28

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-të) për vitin 2012 për Komunën e Rahovecit. Dëshiroj ta falënderoj Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Auditimi i PVF për vitin 2012 ishte ndërmarrë në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me PVF.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Vlerësimin nëse PVF paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale;
- Menaxhimin Financiar dhe Auditimin e Brendshëm, duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit; dhe
- Procedurat e pajtueshmërisë.

Opinion

Auditori i Përgjithshëm (AP) i raporton Kuvendit për opinionin e tij në formatin e përcaktuar në nën kapitullin 2.3 - Opinioni i Auditimit. Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e ZAP. Raporti i AP-së përfshin një opinion për vërtetësinë dhe drejtësinë e PVF.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm. Regjistri i pasurive fikse nuk ka ndikim në ndonjëren prej 2 Pasqyrave Vjetore Financiare (Pranimet dhe Pagesat e Parasë së Gatshme dhe Krahasimin e Buxhetit dhe Shumat Aktuale), në pajtim me IPSAS në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme. **(SNISA: 400 Opinion i Pakualifikuar me Theksim të Çështjes)**

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni jonë i përgjithshëm e pasqyron rishikimin tonë të kontrolleve të ndërlidhura me PVF-të, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

Një numër përmirësimesh ishte bërë nga ana e menaxhmentit gjatë vitit të kaluar, në aspektin e procedurave të kontrollit financiar dhe proceseve. Megjithatë, mbetet që përmirësimet të vazhdojnë për të siguruar se një aplikim konsistent dhe gjithëpërfshirës të përshtatshmërisë së kontrolleve në të gjithë sektorët e komunës.

Rekomandimet e auditimit kanë për qëllim përmirësimin e kontrolleve financiare dhe aspektet tjera të aktiviteteve operative. Ne kemi shqyrtuar përgjigjet në rekomandimet e vitit 2011 dhe gjendja e tyre është përmbledhur në Aneksin II. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se rekomandimet tona nuk janë adresuar në masë të duhur. Në veçanti ato nuk janë adresuar në fushat, si: Procesi i përgjithshëm buxhetor dhe subvencionet, ndërsa pjesërisht ishin trajtuar: të hyrat, prokurimi, pasuritë dhe borgjet. Ne konkludojmë se menaxhmenti i komunës duhet t'i implementoj të gjitha rekomandimet e auditimit, për t'iu shmangur dobësive që po përsëriten vite me radhë. Aty ku rekomandimet nuk janë adresuar, ne jemi detyruar që ato t'i përsërisim edhe këtë vit, me kërkesën që ato të adresohen brenda një afati optimal.

Ne e kemi diskutuar cilësinë e kontrollit financiar të komunës dhe gjetjet e auditimit në kontekstin e Pasqyrave vjetore financiare, menaxhimit financiar dhe kontrolleve, dhe llogaridhënies menaxheriale dhe auditimit të brendshëm me organet drejtuese të komunës.

Rekomandimet tona kryesore për Kryetarin e Komunës janë si në vijim:

Pasqyrat vjetore financiare

- Të bëhet shpalosje e plotë e pasurive në Pasqyrat Vjetore Financiare, në pajtim me standardet dhe kërkesat ligjore në fuqi.

Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

- Të bëhet një planifikim më i mirë dhe i qëndrueshëm për tatimin në pronë dhe masa shtesë të merren në fushën e inkasimit nga tatimi në pronë. Një monitorim i vazhdueshëm i pronave të dhëna me qira subjekteve të ndyshme, është i nevojshëm, në mënyrë që të mos vazhdohen kontratat pa kryerjen paraprake të obligimeve të mbetura.
- Kryetari duhet të shtojë kontrollet e prokurimit, duke respektuar kriteret e vendosura në dosjen e tenderit. Po ashtu, pagesat nga kategoria e investimeve kapitale pa procedura të prokurimit, duhet të ndalohej;
- Të aprovoj Rregulloren për Subvencione dhe Transfere, e cila do të shërbej si një dikument bazë për dhënien e subvencioneve; dhe
- Regjistrimin e të gjitha pasurive që janë në pronësi të komunës dhe azhurnimin në vazhdimësi të regjistrave të pasurisë.

Sistemi i auditimit të brendshëm

- Gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm do të diskutohen dhe adresohen në të gjitha nivelet e menaxhimit.

Përgjigja nga Menaxhmenti – auditimi për 2012

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe janë zotuar se do ti adresojnë rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Është përgjegjësi e Menaxhmentit të përgatis PVF sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit ka reflektuar vlerësimin e rrezikut tonë të auditimit për Komunën e Rahovecit. Ne kemi konsideruar të kuptuarit tonë për organizatën, deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale dhe nivelin e testimit të hollësishëm të kërkuar gjatë përcaktimit të testimeve të përgjithshme e që janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2011 mund të gjendet në Shtojcën II.

Ne kemi përfshirë të gjeturat e rëndësishme dhe të tjera më pak të rëndësishme, që dalin nga auditimi ynë. Për plotësinë ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të 9 mujorit aty ku ishte relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të rëndësishme - Çështjet kryesore për vëmendjen e atyre që janë të ngarkuar me qeverisje dhe menaxhmenti i lartë e që mund të ketë potencial të rezultojë në një dobësi materiale në kontrollet e brendshme; dhe

Të tjera - Dobësitë e identifikuar në auditimin tonë, ku veprimi do të ofrojë potencialin për përmirësime në efikasitet dhe efektivitet të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në PVF. Ne gjithashtu e konsiderojmë deklaratën e bërë nga ZKA dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF. Një numër i pikëve në deklaratë kanë për qëllim të ofrojnë siguri për Qeverinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithë përfshirës.

2.1 Pajtueshmëria me kornizën raportuese

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna e Rahovecit ka përgatitur PVF në pajtim me kërkesat e Rregullës Financiare 07/2011 mbi raportimin vjetor të organizatave buxhetore dhe SNKSP “Raportimi financiar në bazë të Kontabilitetit të parasë së gatshme” përveç çështjes së pasurive që është trajtuar tek kapitulli cilësia dhe saktësia e informatave. Këshillat e dhëna në pasqyrat financiare nëntëmujore ishin adresuar nga ana e menaxhmentit.

Përshkrimi

Pasqyrat vjetore duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi vërejtur se:

- PVF janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në MF;
- PVF janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ (Kryetari i Komunës) dhe Zyrtari Kryesor Financiar;
- PVF janë pranuar në gjuhën shqipe dhe serbe;
- PVF janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike; dhe
- Komuna ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Ministri i MF gjatë vitit 2012.

2.2 Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare

Konkluzioni i përgjithshëm

PVF, përveç shpalosjes së plotë të pasurive, ishin përgatitur në pajtim me kërkesat e Rregullës Financiare nr. 07/2011, dhe SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” ku është përdorur formati standard i raportimit.

1. Çështja - Procesi i përgatitjes së PVF-ve - Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura Te shënimi 30: Përmbledhje e pasurive jo financiare, vlera e pasurive që është prezentuar në PVF nuk është e saktë, pasi që në të nuk janë përfshirë të gjitha pasuritë që janë në posedim të komunës. Ne kemi identifikuar pasuri me vlerë 2,419,356€ që nuk janë prezentuar në PVF.

Te shënimi 31: Përmbledhja e pasurive jo financiare me vlerë nën 1,000€, komuna kishte prezentuar vlerën prej 473,000€. Në mungesë të shënimeve të qarta, ne nuk ishim në gjendje që të vërtetonim saktësinë e shumave të prezantuara në PVF.

Rreziku Mos prezantimi korrekt i vlerës së pasurive shpie në keqkuptimin e pozitës financiare të komunës, si dhe mundësinë e keqkuptimit të kërkesave buxhetore në të ardhmën. Për më shumë, nuk është i mundur një menaxhim efektiv i pasurive.

Rekomandimi 1 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se plani sistematik i përpilimit të pasqyrave financiare inkorporon kërkesën për të përfshirë tërë vlerën e pasurive. Kryetari ka nevojë të monitoroj zbatimin e kësaj kërkesë.

2.3 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm. Regjistri i pasurive fikse nuk ka ndikim në ndonjëren prej 2 Pasqyrave Vjetore Financiare (Pranimet dhe Pagesat e Parasë së Gatshme dhe Krahasimin e Buxhetit dhe Shumat Aktuale), në pajtim me IPSAS në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme. **(SNISA: 400 Opinion i Pakualifikuar me Theksim të Çështjes)**

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti i komunës kishte trajtuar vetëm pjesërisht rekomandimet tona të dhëna vitin e kaluar. Si rezultat i kësaj janë përsëritur dobësitë e njëjta të viteve të mëparshme.

Përshkrimi

ZAP kishte kontraktuar kompaninë e auditimit "Grant Thornton" për auditimin e PVF të Rahovecit për vitin 2011, që ka rezultuar me dhënien e 10 (dhjetë) rekomandimeve kryesore. Menaxhmenti i Komunës nuk kishte përgatitur një Plan Veprimi për implementimin e rekomandimeve të dhëna.

Në fund të auditimit kemi vërejtur se 2 (dy) rekomandime janë adresuar plotësisht, 6 (gjashtë) janë adresuar pjesërisht apo janë në proces të adresimit, ndërsa 2 (dy) nuk janë adresuar fare. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II në fund të këtij raporti.

2. Çështja - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioriteti - I rëndësishëm

- | | |
|----------------------|--|
| E gjetura | Komuna ka arritur të adresoj dy rekomandime, dhe gjashtë prej tyre i kishte zbatuar vetëm pjesërisht. Rekomandimet e pa adresuara ndërlidhen me fushat: procesin e përgjithshëm buxhetor dhe subvencionet. |
| Rreziku | Dështimi i adresimit të rekomandimeve rrit rrezikun që dobësitë e kontrolleve të brendshme në sistemet kyçe financiare të rezultojnë me përsëritjen e dobësive në zbatimin e buxhetit. |
| Rekomandimi 2 | Kryetari i Komunës duhet të sigurojë një plan veprimi për adresimin e rekomandimeve të ZAP që në mënyrë të qartë përcakton një afat kohor dhe anëtarët e stafit llogaridhënës, të identifikuar - me fokus fillestar në ato të një rëndësie të madhe. |

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Hyrje

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Kjo mund për shembull, të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrolleve operative të nivelit më ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjat e llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti.

Aty ku është e përshtatshme, ne gjithashtu e konsiderojnë vetë-vlerësimin e bërë nga menaxhmenti i komunës sipas kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrolleve.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna kishte shpenzuar buxhetin përfundimtar në shkallën prej 98%, që mund të konsiderohet si performancë e lartë e ekzekutimit. Për cilësinë e shpenzimeve dhe procedurat e ndjekura, do të flitet në vijim të raportit.

Përshkrimi

Ne kemi konsideruar burimin e fondeve buxhetore për Komunën e Rahovecit, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrave të mbledhura. Shifrat janë prezantuar në tabelat e mëposhtme.

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi	2010 Shpenzimi
Burimet e Fondeve	9,362,487	10,495,095	10,276,518	9,965,837	7,734,525
Granti i Qeverisë-Buxheti	8,548,487	9,068,487	9,061,614	8,758,131	7,081,485
Të bartura nga viti paraprak -	-	342,471 ²	333,620	305,977	115,035
Të hyrat vetanake	814,000	814,000 ³	615,107	633,904	538,005
Donacionet Vendore	-	32	-	2,380	-
Donacionet e Jashtme	-	270,105	266,177	265,445	-

Buxheti Final ndryshon nga Buxheti Fillestar për 1,132,608€. Ky ndryshim është për shkak të bartjes së të hyrave vetjake nga viti i kaluar, në shumë prej 342,471€, granteve të papërcaktuara të donatorëve në shumë prej 270,137€, ndarjet me rishikim të buxhetit prej 10,000€ për Mallra dhe shërbime, ndërsa me vendimet të Qeverisë së Republikës së Kosovës komunës i janë ndarë 415,000€ për projekte kapitale, për Paga dhe Mëditje 30,000€, për Mallra dhe Shërbime 50,000€, dhe për komunalitë 15,000€.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi	2010 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	9,362,487	10,495,095	10,276,518	9,965,837	7,734,525
Pagat dhe Mëditjet	5,105,700	5,365,700	5,361,722	5,151,332	3,995,808
Mallrat dhe Shërbimet	740,367	956,669	939,328	876,762	608,556
Komunalit	277,758	292,758	292,565	268,618	268,103
Subvencionet dhe Transferet	100,000	100,000	94,141	123,759	119,679
Investimet Kapitale	3,138,662	3,779,968	3,588,762	3,545,366	2,742,379

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi, që është e përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

² Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Të hyrat vetanake komunale të planifikuara.

Buxheti është shpenzuar rreth 98% në nivel të përgjithshëm, që mund të vlerësohet si një performancë e lartë për komunën.

Tabela 3. Të hyrat vetjake komunale planifikuara dhe të mbledhura në vitin 2012 (në euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Pranimi	2011 Pranimi	2010 Pranimi
Të hyrat vetanake	814,000	814,000	800,404	888,000	784,000

Siç shihet nga tabela të hyrat e planifikuara për vitin 2012 janë realizuar 98%, që tregon se ka pasur një realizim sipas planit të paraparë. Mirëpo, nëse i krahasojmë të hyrat e realizuara në vitin 2011 ka pasur një rënie rreth 87,500€. Rënia ka qenë tek Gjobat e Trafikut dhe Gjobat nga Gjykata.

4.3 Kërkesat e raportimit

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat që dalin nga legjislacioni në fuqi sa i përket raportimit të jashtëm. Ajo nuk ka bërë vetëvlerësim, siç kërkohet me rregullat e MFK-së, nuk ka përgatitur plan për implementimin e rekomandimeve të dhëna në vitin e kaluar, si dhe nuk kishte dorëzuar çdo muaj raportet mbi borxhet në MF. Së këndejmi, komuna nuk ju ka përmbajtur të gjitha kërkesave që dalin nga fusha e raportimit.

Përshkrim

Ne kemi konstatuar se Komuna e Rahovecit për pikat në vijim i ka përmbushur kërkesat për raportim të jashtëm:

- Kërkesa Buxhetore për financimin e projekteve kapitale në Ministrinë e Financave;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Raportet Operacionale (performancës);
- Draft Plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë;

Rekomandim

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të inicojë dhe përmbush kërkesën për vetëvlerësimin e sistemeve të saj, për të siguruar që burimet e saj janë shpenzuar sipas parimit të vlerës për para, në mënyrë efikase, efektive dhe ekonomike. Po ashtu, të raportoj në

baza mujore për borxhet në MF si dhe të përgatitë planin për implementimin e rekomandimeve të dhëna.

4.4 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Konkluzion i përgjithshëm mbi të hyrat

Komuna e Rahovecit ka vendosur kontolle të mira mbi të hyrat. Me gjithë përmirësimet, komuna duhet ta përgatitë një planifikim për tatimin në pronë të bazuar në analiza të mirëfillta sipas bazave të ngarkesave reale, si dhe të nxjerrë politika të qarta me mekanizmat e duhur se si të inkasohen borxhet e mbetura nga vitet paraprake, Po ashtu, tek pronat e dhëna me qira, duhet t'i ndërprej praktikat e vazhdimet të kontratave, para se të jenë paguar të gjitha detyrimet e mbetura.

Përshkrimi

Të hyrat e gjeneruara nga Komuna e Rahovecit në vitin 2012 ishin në total 800,404€. Këto shumat të mbledhura kanë të bëjnë me Të Hyrat nga Tatimi në Pronë; Të Hyrat nga Qiratë; Taksat Administrative etj.

3. Çështja - Tatimi në Pronë - Prioriteti - I rëndësishëm

- E gjetura** Komuna kishte planifikuar të realizonte të hyra nga tatimi në pronë gjatë vitit 2012 shumën prej 210,000€, ndërsa kishte realizuar shumën prej 265,460€. Nga kjo shihet një tejkalim i planit, mirëpo bazuar në vitin paraprak ku të hyrat kanë qenë 228,839€, del se nuk është bërë një planifikim i mirë, pasi që planifikimi për vitin 2012 është më i ultë se realizimi në vitin 2011.
- Ne nga baza e të dhënave e tatimit në pronë, ne kemi marrë për testim 36 mostra në vlerë 45,259€, ku 18 prej tyre nuk kanë paguar tatimin për vitin 2012 në një vlerë prej 13,726€. Borxhi i akumuluar ndaj komunës për këtë lloj tatimi ishte 1,244,107€. Komuna nuk kishte hartuar ndonjë plan apo strategji se si t'i inkasoj borxhet e vjetra.
- Rreziku** Politikat e planifikimit duket të jenë të dobëta për të siguruar maksimizimin e të hyrave, e po ashtu edhe kontrollet operative nuk janë efektive. Kësisoj mund të kemi një nënpagim të të hyrave. Vonesat në mbledhjen e të hyrave, sjellin edhe dështimet në vendimmarrjen e menaxhmentit për financimin e projekteve nga ky burim.
- Rekomandimi 3** Kryetari i Komunës duhet të ketë një çasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e të hyrave, si në kuptimin e planifikimit ashtu edhe në vendosjen e mekanizmave efektiv për realizimin e parametrave të planifikuar. Kryetari duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumëve domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë).

4. Çështja - Të hyrat nga Qiratë - Prioriteti - I rëndësishëm

- E gjetura** Komuna nga pronat e dhëna me qira kishte planifikuar të realizoj 41,000€, ndërsa kishte inkasuar 40,125€. Ne kemi testuar 9 mostra dhe kemi identifikuar këto mangësi:
- Në 5 (pesë) raste komuna u kishte vazhduar kontratat subjekteve të ndyshme për dhënjen e pronës me qira, edhe pse ata nuk kishin paguar asnjëherë obligimet ndaj komunës. Obligimi total i tyre i grumbulluar nëpër vite është në vlerë 136,034€.
- Rreziku** Nuk janë të qarta arsyet e vazhdimit të kontratave për subjektet që nuk kanë paguar kurrë. Mos pagesa e obligimeve sipas kontratave nga qiramarrësit, dhe vazhdimi i kontratave nga komuna, pa i kryer obligimet e mëhershme rrisin rrezikun e nënpagimit të të hyrave dhe mos realizimin e projekteve të planifikuara nga burimet vetjake.
- Rekomandimi 4** Kryetari i Komunës duhet t'i shqyrtoj këto kontrata dhe të insistoj inkasimin e borxheve të mbetura. Në të kundërtën, kontratat duhet të ndërpriten. Një rishikim i vazhdueshëm i kontratave dhe forcimi i kontrolleve duhet të bëhet nga menaxhmenti.

4.5 Shpenzimet

Konkluzion i përgjithshëm mbi shpenzimet

Komuna ndonëse ka të dizajnuara kontrolle formale mbi shpenzimet, por ato nuk operojnë në mënyrën e duhur. Pagesat pa procedura të prokurimit në disa raste, mos respektimi i afatit prej 96 orësh për hapjen së ofertave deri te formimi i komisionit për vlerësimin e ofertave, shpërblimi i ofertuesve të papërgjegjshëm, janë vetëm disa raste që përshkruajnë dështimin e kontrolleve.

4.5.1 Prokurimi

Përshkrimi

Kontratat e lidhura për vitin 2012 ishin në vlerë prej 3,992,897€.

Ne kemi analizuar nëse projektet për investime kapitale kanë qenë të përfshira në PIP dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Gjithashtu, kemi rishikuar nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim gjatë vitit lidhur me projektet e parapara të realizohen gjatë vitit. Ne kemi vlerësuar se nuk ka pasur ndonjë çështje lidhur me këto për të ngritur në këtë raport.

Ne kemi ekzaminuar 63 mostra (pagesa) në vlerë 1,231,773€. Përveç rasteve të identifikuar në vijim, procedurat e prokurimit ishin konform rregullativës ligjore në fuqi.

5. Çështja - Certifikim i parregullt i pagesave – Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura Gjatë testimit të kategorisë së Investimeve Kapitale, në 6 (gjashtë) raste kemi vërejtur se komuna kishte bëra pagesa në shumë prej 11,803€, nga kodi i investimeve kapitale, pa procedura të prokurimit vetëm me vendim të kryetarit. Projektet e paguara ishin: lyerja dhe riparimi i tezgave; Pije dhe ushqim në festivalin e folklorit; Për mirëmbajtjen e semaforëve; Për reklama në panairin për ndërtimin e kanalizimit dhe shtruarjen me kubëza betoni; Për ndërtimin e pengesës në hyrje të oborrit.

Po ashtu, në 8 (tetë) raste ishin bërë pagesa me vendime të kryetarit të komunës në vlerë prej 13,400€ prej kategorisë së investime kapitale për mbështetjen financiare të klubeve të sportit në komunën e Rahovecit dhe për OJQ-të të ndryshme. Në këto pagesa mungonin kërkesat prej përfituesve, nuk kishte ndonjë raport se si janë shfrytëzuar mjetet e dhëna. Mbështetja e klubeve dhe e OJQ-ve ishte bërë pa procedura të prokurimit.

Rreziku Pagesat e kryera nga kategoritë jo adekuate rrisin rrezikun që palnifikimet buxhetore të devijojnë nga ndarjet fillestare. Për më tepër, pagesat jashtë procedurave të prokurimit dëmtojnë konkurrencën dhe transparencën e procesit.

Rekomandimi 5 Kryetari i Komunës duhet të siguroj se buxheti do të realizohet në pajtim me aprovimet paraprake dhe të gjitha shpenzimet do të bëhen sipas kategorive përkatëse buxhetore. Në të kundërtën, duhet ndjekur procedurat normale buxhetore për transfere prej një një kategorie ekonomike në tjetrën. Gjithashtu, duhet ndjekur procedurat e prokurimit dhe raportimit nga ana e shfrytëzuesve.

6. Çështja - Shpërblim i Operatorit Ekonomik të pa përgjegjshëm - Prioriteti - I rëndësishëm

- E gjetura** Komuna kishte zhvilluar procedura të hapura të tenderimit për “Funizim me material administrativ”ku kishin ofertuar 6 OE. Prej tyre 2 ishin vlerësuar si të përgjegjshëm. Kriteret e dosjes së tenderit kërkonin që tenderuesit të sillnin dokumente origjinale ose kopje të vërtetuara. Dokumentet e ofruara nga OE Office 1 Kosov i shpërblyer me kontratë, Vërtetimi i ATK-së dhe Vërtetimi i tatimit në pron nuk ishin origjinal, por kopje të pa vërtetuara. Komuna kishte proceduar dhe shpërblyer me kontratë OE të lartë cekur në mungesë të dy operatorëve ekonomik të përgjegjshëm.
- Rreziku** Mos respektimi i kriterëve të kërkuara gjatë vlerësimit të ofertave ka rezultuar me shpërblim të kontratës Operatorin Ekonomik të pa përgjegjshëm, që nuk është në pajtim me rregulloret e prokurimit.
- Rekomandimi 6** Kryetari i Komunës duhet të siguroj se shërbimi i prokurimit administron procesin e prokurimit në bazë kërkesave ligjore, përgjatë të gjitha fazave, duke respektuar të gjitha kriteret e parashikuara me dosjen e tenderit.

7. Çështja - Njoftimi i Tenderuesve të Eliminuar- Prioriteti - Tjetër

E gjetura Ligjislacioni parasheh që autoriteti kontraktues, qoftë nëpërmjet shkresave elektronike apo formave tjera të komunikimit t'i njoftoj OE të eliminuar duke e arsyetuar vendimin e marrë. Në gjatë rishikimit të dosjeve të tenderëve kemi identifikuar se në 8 (tetë) raste komuna nuk kishte njoftuar OE të eliminuar. Në vijim po i paraqesim rastet e identifikuar: Furnizim me material higjieno-sanitar dhe ushqimor për nevojat e Komunës së Rahovecit; Furnizim me material teknik për nevojat e Komunës së Rahovecit; Furnizim me inventar për nevojat e QKMF-së; Furnizim me material administrativ; Furnizim me dru dhe thëngjill për nevojat e Komunës së Rahovecit; Ndërtimi i objektit të AMF-së dhe rrethimi i oborrit të shkollës në fshatin Xerxë; Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin Pataqan i Poshtëm; dhe Fasadimi i objekteve të banimit në Rahovec-Ritenderim.

Rreziku Mos njoftimi i OE të eliminuar paraqet rrezik që OE të mos jenë të informuar me kohë për vendimet e marra nga AK dhe që të humbin të drejtën për ankesë tek organet kompetente.

Rekomandimi 7 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të gjithë tenderuesit e eliminuar, të njoftohen me kohë dhe në mënyrën e paraparë me legjislacion duke iu shpjeguar edhe të drejtat dhe mundësitë për ankim. Njoftimi i OE është kërkesë ligjore, dhe si i tillë duhet zbatuar nga shërbimi i prokurimit.

8. Çështja - Mos respektimi i afatit ligjor me rastin e formimit të komisioneve të vlerësimit të ofertave - Prioriteti - Tjetër

E gjetura Kemi vërejtur se në 8 (tetë) raste tek procesi i prokurimit formimi i komisionit për vlerësim të tenderëve ishte me vonesë diku prej 9 deri 20 ditë, ku sipas Udhëzuesit operativ për prokurimin publik, procesi i vlerësimit të tenderit duhet të fillojë jo më vonë se 96 orë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.

Rreziku Mos formimi i komisioneve të vlerësimit brenda afatit ligjor prej (96 orëve) nga hapja e ofertave nuk ka ndonjë ndikim financiar, megjithatë raste të tilla nuk janë në përputhje me rregullat e prokurimit.

Rekomandimi 8 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se komisionet për vlerësimin e ofertave të formohen brenda afateve të përcaktuara, menjëherë pas procesit të hapjes së ofertave.

4.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Buxheti i planifikuar për paga dhe mëditje ishte 5,365,700€, ndërsa shpenzimet për këtë kategori ishin 5,361,722€. Buxheti në këtë kategori ishte shpenzuar në shkallë maksimale.,

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar qeveritar. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: a) kontrollin e pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listat e pagave: b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve: dhe c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Për këtë kategori testuam 40 mostra ku rishikuam se a janë në pajtueshmëri listat e pagave me sistemin e payrollit në MAP. Po ashtu, kemi shikuar nëse pozitat e zyrtarëve dhe koeficientët janë në pajtueshmëri me formën e sistemit të payrollit, si dhe rregullsinë e dosjeve të personelit, procesin e vazhdimin të kontratave të të punësuarve, rekrutimin e stafit të rinjë, dhe kemi vërejtur:

9. Çështja - Procesimi i Pagave - Prioriteti - Tjetër

E gjetura Në dy raste të shfrytëzimit të pushimit të lehonisë, komuna ka vazhduar t'i paguaj me 70% të pagës bazë edhe pas 6 muajve të shfrytëzimit të pushimit, ku sipas ligjit të punës është dashur të paguhen nga komuna vetëm për 6 muajt e parë, ndërsa për periudhën e tretë pagesa bëhet nga Qeveria e Kosovës për 50% të pagës mesatare në Kosovë.

Në shtatë raste të pagesave për punë jashtë orarit, Komuna nuk i ka respektuar të gjitha procedurat që parashihen me ligjin për pagat ku kërkohet që paraprakisht të merret autorizimi nga mbikëqyrësi për lejimin e orëve shtesë, si dhe mungonte vërtetimi me shkrim nga mbikëqyrësi për orët faktike të plotësuar.

Rreziku Zyra e personelit nuk ka azhurnuar dosjen e personelit dhe për pasojë ka ndodhë këto pagesa jo korrekte. Kjo rritë rrezikun e pagesave në kundërshtim me Ligjin dhe rregulloret në fuqi.

Rekomandimi 9 Kryetari i Komunës përmes mekanizmave të vetë duhet ta bëjë një shqyrtim sistematik të dosjeve të personelit për të siguruar se i tërë dokumentacioni dhe ndryshimet e nevojshme janë përfshirë, brenda periudhës së specifikuar kohore. Kryetari duhet të rishqyrtoj rastin nëse pagesat ishin të bazuara.

10. Çështja - Mos respektimi i procedurave të rekrutimit- Prioriteti - Tjetër

- E gjetura** Sipas Rregullores për Rekrutim nr. 02/2010 kërkohet që gjatë procesit të rekrutimit të jenë së paku pesë kandidatë në mënyrë që të zhvillohet procedura e më tutjeshme, ndërsa tek konkursi me nr. ref 1833/2012-Asistente në zyrën e turizmit, në listën e aplikuesve figurojnë me pak se pesë kandidatë dhe kandidatja ishte përzgjedhur.
- Rreziku** Mos respektimi i procedurave të rekrutimit ndikon që stafi i përzgjedhur mund të mos ketë kompetencën e duhur për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi në raport me kërkesat e vendit të punës.
- Rekomandimi 10** Kryetari i Komunës duhet të siguroj se me rastin e rekrutimit të personelit, procesi i rekrutimit të jetë objektiv dhe transparent, duke synuar që të pranohet stafi sa më cilësor dhe më i përshtatshëm për komunën.

4.5.3 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Komuna për vitin 2102 për Subvencione dhe Transfere kishte buxhetuar shumën prej 100,000€, prej të cilave kishte shpenzuar 94,141€. Këto subvencione ndahen kryesisht për entitete publike dhe entitete jo publike (individ) me vendime të kryetarit të komunës. Komuna nuk kishte administruar kontrolle të mjaftueshme në përcjelljen e fondeve të ndara. Ne kemi testuar 16 mostra në këtë kategori në vlerë 27,727€ dhe kemi identifikuar çështjet në vijim:

11. Çështja - Baza ligjore Prioriteti - I rëndësishëm

- E gjetura** Komuna nuk ka një rregullore të shkruar për ndarjen e mjeteve financiare për subvencione.
- Rreziku** Shpenzimet e planifikuara për subvencione dhe transfere mund të mos kenë arritur qëllimin. Mungesa e politikave/rregulloreve të brendshme, reflekton mangësinë e procedurave që duhet ndiqen me rastin e subvencionimeve.
- Rekomandimi 11** Kryetari i Komunës duhet që të sigurojë se do të hartohet një Rregullore që specifikon qartë kriteret, procedurat dhe burimet e subvencioneve.

12. Çështja - Mungesë e dokumentacionit mbështetës- Prioriteti- Tjetër

E gjetura Komuna kishte subvencionuar kompaninë “Destani Trans” për kryerjen e shërbimeve të transportit ndaj shoqatës për ruajtjen e vlerave kulturore artistike “Arbëria” në vlerë prej 1,400€. Ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë dëshmi për shërbimet e kryera, si psh: lista e pjesëmarrësve (udhëtarëve) apo ndonjë raport përfundimtar nga ana e përfituesit se si janë shpenzuar fondet.

Rast i ngjashëm ishte edhe me subvencionimin e klubit futbollistik Rahoveci me dy pagesa, në vlerë prej 2,000€ dhe 2,800€.

Rreziku Mungesa e informatave kthyesë, siç janë raportet financiare dhe raportet tjera përshkruese, nuk sigurojnë se shpenzimet e planifikuara për subvencione dhe transfere kanë arritur qëllimin.

Rekomandimi 12 Kryetari i Komunës duhet që të siguroj se janë vendosur kontrolle të duhura për shpenzimet e subvencioneve, në pajtim me ndarjet fillestare.

4.6 Pasuritë

Konkluzioni i përgjithshëm mbi pasuritë

Si rezultat i përmirësimeve në regjistrin e pasurive, vlera e pasurisë së regjistruar ishte rritur dukshëm, krahasuar me vitin paraprak. Megjithatë, një regjistër i plotë dhe i besueshëm ende nuk është përfunduar. Kjo mbetet një objektive që menaxhmenti duhet ta adresoj në të ardhmën. Një komision i inventarizimit ishte themeluar, mirëpo raporti i inventarizimit nuk ishte përgatitur, dhe kjo ka ndikuar që ndryshimet të mos reflektohen në regjistrat përfundimtar. Ne nuk ishim në gjendje të konfirmonim vlerën e pasurive nën 1,000€, të shpalosura në PVF-të.

4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Në fund të vitit 2011 vlera neto e pasurive në regjistrin kontabël ishte 222,508€ ndërsa në fund të vitit 2012-të 88,750,211€. Kjo rritje është si pasojë e regjistrimit të pasurive të më hershme.

13. Çështja - Mos regjistrimi i pasurive dhe azhurnimi i tyre - Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura

Komuna nuk ka bërë regjistrimin dhe azhurnimin e rregullt të pasurive në regjistrin kontabël të pasurive. Një komision i inventarizimit ishte themeluar në shtator 2012, por nuk kishte hartuar ndonjë raport .Ne gjatë auditimit kemi rishikuar pagesat për investime kapitale, të bëra gjatë vitit 2012-të dhe kemi identifikuar raste kur komuna nuk kishte regjistruar pasuritë si në vijim:

- Ndërtesa administrative afariste - 53,628€;
- Objekte kulturore - 139,872€;
- Rrugë lokale - 495,996€;
- Trotuare - 56,667€;
- Rrjet të kanalizimit - 363,879€;
- Rrjet të ujësjellësit - 70,045€;
- Automjete (autoambulanca) - 44,942€;
- Trafo elektrike - 35,939€;
- Kapital tjetër - 357,582€.

Komuna nuk mban një regjistër të brendshëm ndaras për pasuritë në vlerë mbi 1,000€ në pajtim me nenin 11 të UA 21/2009.

Udhëzimi kërkon që pasuritë të regjistrohen në bazë të faturës dhe fletëpranimit të pasurive. Zyrtari i pasurisë nuk përdor dokumente burimore siç janë Urdhër Obligimi Për Pagesë, Fatura apo dokumente tjera që vërtetojnë se pasuritë janë blerë apo pranuar donacion gjatë regjistrimit të pasurive në regjistrin kontabël -SIMFK.

Rreziku

Mos regjistrimi i të gjitha pasurive ka ndikuar që vlerat e shpalosura në pasqyra financiare të mos jenë të sakta dhe të plota. Po ashtu, një regjistër jo i plotë paraqet një rrezik potencial të vazhdueshëm të humbjes, tjetërsimit apo keqpërdorimit të pasurisë.

Rekomandimi 13

Kryetari i Komunës duhet të inicoj një proces sistematik të regjistrimit të pasurive. Kryetari duhet të siguroj që sa më parë të formoj një komision i cili do të bënte vlerësimin dhe inventarizimin e drejtë dhe të plotë të të gjithë pasurive fikse që janë në pronësi të komunës si dhe të monitoroj rezultatet e vlerësimit.

5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Konkluzion i përgjithshëm mbi sistemin e auditimit të brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet prej Drejtorit dhe një zyrtari të auditimit. Raportet ishin kryer sipas planit të paraparë duke mbuluar vitin 2011 dhe 2012.

Ne kemi rishikuar edhe punën e komitetit të auditimit ku kishte mbajtur takime të rregullta dhe kishte trajtuar rekomandimet e dhëna nga ZAP dhe NJAB-i.

Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij, ne po e prezantojmë këtu ndaras: fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit.

NJAB-i për vitin 2012 kishte planifikuar të kryej gjashtë auditime dhe kishte arritë që ta realizoj planin në tërësi, me fushëveprim vitin 2011 dhe 2012. Auditimet ishin kryer në fushat: (a) menaxhimi i shpenzimeve dhe të hyarave në QKMF, (b) auditimi i procesit të Prokurimit, (c) auditimi në drejtorinë për Buxhet dhe Financa për të hyrat dhe shpenzimet (d) auditimin në drejtorinë për Urbanizëm Palnifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Ambientit për lejet e ndërtimit, lejet urbanistike, taksat për shërbime komunale (e) auditim në drejtorinë komunale të Arsimit për të hyrat dhe shpenzimet dhe (f) auditimin në drejtorinë e Administratës së Përgjithshme për të hyrat. Po ashtu, me kërkesë të kryetarit kishte kryer një auditim për shfrytëzimin e objekteve të përkohshme në komunën e Rahovecit.

14. Çështja - Mosadresimi i rekomandimeve të NJAB - Prioriteti - Tjetër

E gjetura Ne gjatë auditimit kemi vërejtur se menaxhmenti nuk është marrë seriozisht me adresimin e rekomandimeve të dhëna nga NJAB..

Rreziku Mospërgatitja e një plani të veprimit dhe mos adresimi i rekomandimeve rrit rrezikun që dobësitë e njëjta të përsëriten, e në raste të caktuara edhe të rezultojnë me humbje financiare.

Rekomandimi 14 Kryetari i Komunës duhet të bëjë plan veprimi dhe të përcaktoj se si gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm të adresohen nga të gjitha nivelet e menaxhimit si dhe NJAB-i të fokusohet më shumë në auditimet për vitin aktual.

6 Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni jonë i përgjithshëm e pasqyron rishikimin tonë të kontrolleve të ndërlidhura me PVF-të, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

Konkluzioni ynë është se Menaxhmenti i Komunës kishte dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm në nivel të kënaqshëm, por sistemi duhet në vazhdimësi të monitorohet për tu siguruar se kontrollet janë në veprim.

Në vazhdim po i paraqesim fushat në të cilat janë vërejtur mangësitë e përshkruara në këtë raport, për të cilat vëmendja e menaxhmentit duhet të jetë e fokusuar në veçanti:

Pasqyrat Vjetore Financiare - komuna nuk kanë shpalosë vlerat e plota të pasurive mbi dhe nën 1,000€, prandaj nuk mund të kuptohet gjendja e tanishme e llogarisë së pasurive.

Menaxhmenti kishte bërë përpjekje për të adresuar rekomandimet tona, por nuk ka arritë që ato t'i adresoj në nivelin e kërkuar. Ne mendojmë se menaxhmenti duhet t'i trajtoj rekomandimet e auditimit në mënyrë më të vendosur.

Të hyrat - ndonëse në përqindje plani gati në tërësi ishte realizuar, mangësitë vijnë në shprehje të shumta e planifikuara. Komuna kishte planifikuar më pak të hyra se në vitin 2011 dhe kjo duket paksa e pa kuptueshme. Llogaritë e arkëtueshme kapin shuma të larta të borgjeve të pa mbledhura, dhe vetëm nga tatimi në pronë ato kapin shumën mbi 1.2 milionë. Nuk është bërë një rivlerësim i borxheve dhe bazave të ngarkesave tatimore. Komuna nuk ka ndonjë strategji si të veprohet me këto llogari. Qiratë juk janë paguar nga kontraktorët, dhe përkundër kësaj, komuna ka vazhduar kontratat. Kontrollet monitoruese funksionojnë dobët.

Te kontraktimi i projekteve kapitale dhe furnizimi me mallra dhe shërbime, nuk zbatohen procedurat e kërkuara të prokurimit, duke zgjedhur ofertues të pa përgjegjshëm, duke vonuar formimin e komisioneve të vlerësimit, duke mos njoftuar operatorët e eliminuar, etj. Kriteret që përcaktohen në dosjet e tenderëve, nuk zbatohen nga ana e komisioneve të vlerësimit. Përveç kësaj, kanë ndodhur pagesa prej kategorisë së investimeve kapitale pa zhvilluar procedura të prokurimit.

Subvencionet edhe më tutje vazhdojnë të ndahen pa ndonjë rregullore që do të specifikonte kushtet, kriteret, prioritetet, mënyrën e raportimit, etj.

Mungesa e regjistrimit të pasurive, po ashtu, nuk ofron pasqyrë reale mbi pasuritë ekzistuese të komunës dhe kësaj pasuritë nuk iu nënshtrohen kontrolleve të mjaftueshme nga menaxhmenti, duke rrit rrezikun që ato të humben apo të keqpërdoren.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një **opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinion i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinion i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponentë e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
5. Pasqyrat Vjetore Financiare	Ne i rekomandojmë Kryetarit të siguron që përgatitja e pasqyrave financiare të Komunës duhet të përfshijë procedurat dhe mjetet që janë projektuar për të siguruar që informacioni i kërkuar është i regjistruar, përpunuar, përmbledhur dhe raportuar në mënyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare.	Po		
6.1 Te hyrat	Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunës që të siguroj që Komuna të ndërmer hapa për përmirësimin e faturimit dhe sistemit kontabël në mënyrë që të sigurohen kontrole të sigurta, efikase dhe efektive në faturim dhe në të ardhura. Përmirësimi i procedurave në lidhje me sisteme të tilla do të mundësojë menaxhmentin të monitorojë dhe menaxhojë rreziqet e mëdha, dhe për të siguruar që vendimet që lidhen me buxhetin, planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave janë kryer siç duhet.		Pjesërisht është realizuar ky rekomandim.	
6.2.1 Pagat dhe Mëditjet	Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj se janë nënshkruar të gjitha listat e pagave të të gjithë muajve. Për më tepër, rekrutimi dhe dosjet e	Po		

	personelit duhet të mbahen në mënyrë të rregullt me të gjitha dokumentet e kërkuara me ligjet në fuqi.			
6.2.2 Prokurimi	Komuna të vendos procedura të mjaftueshme adekuate të kontrollit për monitorimin efektiv të përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret aplikative. Ne i rekomandojmë Komunës të aplikoj në mënyrë të duhur kushtet dhe termet e kontraktuara dhe të shqiptoj denime kur punët nuk përfundohen në kohë. Kjo veçanërisht duhet të aplikohet në rastet kur nuk ka kërkesa për shtyerje të afatit para skadimit të afatit të kontraktuar.		Pjesërisht është realizuar ky rekomandim.	
6.2.3 Subvencionet	Komuna duhet të vendos procedura të mjaftueshme adekuate të kontrollit për monitorimin efektiv të përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret aplikative.			Jo
6.3 Pasuritë	Komuna e Rahovecit të zhvilloj dhe të komunikojë një grup të politikave dhe procedurave në lidhje me pronën, ndërtesat dhe pajisjet. Menaxhmenti duhet të kryejë numërimin fizik dhe verifikimin e ekzistencës së të gjitha pasurive materiale të regjistruara në regjistrin e pronës, pajisjeve dhe impianteve në baza vjetore. Artikujt e humbur duhet të hetohen dhe nëse është e nevojshme të çregjistrohen.		Pjesërisht është realizuar ky rekomandim.	

6.4 Trajtimi i Borxheve	Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunës që të përcjellë dispozitat e Udhëzimeve të Thesarit dhe të rregullit financiar 02 - Shpenzimi i Parasë Publike, të lëshuar nga Qeveria e Kosovës dhe të paguhen borgjet Brenda 30 ditëve.		Pjesërisht është realizuar ky rekomandim.	
6.5 Raportimi Kohor Aktual në Procesin e Përgjithshëm Buxhetor	Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunës që të krijoj kontrolla dhe të merr përgjegjësinë e duhur për të përmbushur kërkesat për raportimin e borgjeve në përputhje me rregullin financiar 04/2011			Jo
7.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm	Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunës që kontrollet e përgjithshme financiare ,administrative dhe menaxheriale janë forcuar; dhe se janë marrë veprimet e menjëhershme për sigurimin e një trajtimi më të mire në të metat e identifkuara në zbatimin e kontrollit të brendshëm.		Pjesërisht është realizuar ky rekomandim.	
8. Konkluzioni i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Komunës	Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunës që të perpiloj politika të qarta për të gjitha aktivitetet e rëndësishme të Komunës dhe të hartoj një plan veprimi duke specifikuar veprimet e menjëhershme.		Pjesërisht është realizuar ky rekomandim.	

